



## ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE)

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, .4 dhe 1.7 të Ligjit për Rregullatorin për Energji (Ligji Nr. 05/L-084), Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22 dhe Aktgjykimin KO 79/2023 të Gjykatës Kushtetuese, Nenin 8 të Ligjit të Punës (03/L-212), Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, 1.3, dhe 1.15 të Rregullës për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, Nenit 15 paragrafi 2 i Manualit të Operimeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji; dhe Nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Vendimit Nr. V\_222\_2024 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me datë 07.08.2024 shpall:

### KONKURS I JASHTËM

#### ANALIST PËR MONITORIM TË TREGUT DEPARTAMENTI I TREGUT TË ENERGISJË

**Kontrata:** e pacaktuar

**Vendi i punës:** Prishtinë

**Paga Bruto:** 890 Euro

#### 1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Analisti për Monitorim të Tregut do t'i ndihmojë dhe raportojë udhëheqësit të Departamentit të Tregut të Energjisë, në monitorimin dhe zbatimin e obligimeve të licencuarve sipas kërkesave ligjore dhe akteve tjera që rregullojnë tregun e energjise.

Ai/ajo do të kontribuojë në kontrollimin dhe Analizon të dhënat e pranuar nga te licencuarit, lidhur me tregun e energjisë elektrike, duke përfshirë vlerësimin e kontratave të lidhura nga pjesëmarrësit e tregut dhe rezultatet i'a prezanton udhëheqësit të departamentit, si dhe kryen sistemimin e dokumentacionit të shkëmbyer me çdo të licencuar që lidhet me fushën që ai/ajo e mbulon

Monitorimi i performancës së licencuarve në mënyrë efektive dhe të reagojë ndaj ndjeshmërisë së tregut të ndërmarrjeve në kohë, transparente dhe të përgjegjshme.

Ai/ajo bashkëpunon me udhëheqësin e Departamentit, departamentet tjera dhe menaxhmentin e ZRRE-së lidhur me aspektet ekonomike dhe tarifore të çështjeve rregullative.

Fusha e punës për këtë pozitë është:

- Analiza dhe raporte të monitorimit
- Draftimi I analizave dhe propozimeve

#### 2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të Departamentit të Tregut të Energjisë, Analisti për Monitorim të Tregut, do të kryej detyrat si në vijim:



- Të monitoron zbatimin e obligimeve të të licencuarve sipas kërkesave ligjore dhe akteve tjera që rregullojnë tregun e energjisë.
- Mbledhja e informatave statistikore mbi tregtimin e energjisë, kapacitetet dhe strukturën e tregut;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave të aktiviteteve energjetike lidhur me energjinë elektrike dhe ngrohjet qendrore etj.
- Asistimi në zhvillimin e modeleve të tregut dhe propozimi i rregullave të tregut.
- Analizimi i qëndrimit të ndërmarrjeve energjetike në treg.
- Analizimi i ndikimeve të rrethanave të ndryshme mbi çmimin e tregut.
- Implementimi i sistemit të monitorimit të çmimeve të tregut.
- Ndiemon dhe bashkëpunon me mbikëqyrësin, dhe bashkëpunon me koleget nga departamentet tjera në monitorimin e aktivitetit të Pjesëmarrësve të Tregut, si dhe ofron mbështetjen e tij/saj duke dhënë vlerësim profesional lidhur me procese të ndryshme të sektorit të energjisë.
- Me kërkesë të mbikëqyrësit, merr pjesë në mbledhjet e Bordit të ZRRE-së, lidhur me prezantimin e dokumenteve të përgatitura nga Departamenti i Tregut të Energjisë.
- Me kërkesë të mbikëqyrësit, përfaqëson ZRRE-në në takime me palët tjera.
- Merr pjesë në grupet punuese të caktuara nga ZRRE, apo me rekomandim të mbikëqyrësit, duke përfshirë edhe aktivitetet trajnuese të përcaktuara nga ZRRE.
- Kontrollon dhe Analizon të dhënat e pranuar nga të licencuarit, lidhur me tregun e energjisë elektrike, duke përfshirë vlerësimin e kontratave të lidhura nga pjesëmarrësit e tregut dhe rezultatet ia prezanton mbikëqyrësit, si dhe kryen sistemin e dokumentacionit të shkëmbyer me çdo të licencuar që lidhet me fushën që ai/ajo e mbulon.
- Kryen detyra konkrete që kanë të bëjnë me realizimin dhe zbatimin e planeve të punës, dhe detyrat që i ngarkohen nga mbikëqyrësi dhe i raporton në vazhdimësi.
- Detyra tjera siç caktohen nga mbikëqyrësi i saj/tij

### **3. KËRKESAT PROFESIONALE/KUALIFIKIMET**

- Të jetë shtetas/e i Republikës së Kosovës;
- Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor të sistemit tre (3) vjeçar, në fushat: Shkencat Inxhinierike (drejtimi inxhinieri elektrike), apo Bachelor në fushën e Ekonomisë, ndërsa grada master cilësohet përparësi;
- Së paku 3 vite përvojë punë në fushën e energjisë, apo të ngjashme;
- Njohuri me punën e sektorit të energjisë është përparësi;
- Njohuri të punës me programet Microsoft Office;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, ndërsa njohja e gjuhës Angleze është përparësi;
- Aftësi për të punuar në ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi për të punuar me një nivel të lartë të besueshmërisë;
- Aftësi për të punuar në shkallë të lartë konfidencialiteti;
- Të jetë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive me palët dhe bashkëpunëtorët;



- Aftësi për të funksionuar mirë si pjesë e një ekipi;
- Të ketë Integritet;
- Të ketë patentë shofer, kategoria B;

#### **4. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak**

Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet, do të shpallet më së largu deri me datën 02.09.2024, në faqes zyrtare të ZRRE.

#### **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

Procedura e vlerësimit të konkursit përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e s' paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit.

Testimi me shkrim – kalueshmëria e testimit me shkrim pesëdhjetë (50) pikë.

Intervistës do ti nënshtrohen vetëm kandidatët që kanë kaluar me sukses testin me shkrim.

Kriteret e vlerësimit për këtë pozitë përfshinë: jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervista deri në njëzetë (20) pikë.

#### **6. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar**

Lista e kandidatit/ve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu me datën 01.10.2024, në faqes zyrtare të ZRRE.

#### **7. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

Përmes emailit zyrtar dhe faqes zyrtare të ZRRE-së.

#### **8. Mënyra e aplikimit**

Përmes emailit zyrtar të ZRRE- së: [rekrutimi@ero-ks.org](mailto:rekrutimi@ero-ks.org)

**Konkursi shpallet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe mbetet i hapur pesëmbdhjetë (15), nga data e publikimit në faqen zyrtare të ZRRE dhe mjetet tjera të informimit (të shkruara apo online).**

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është deri më: 22 gusht 2024 ora 16:00**

**Formularët për aplikim mund t'i shkarkoni online nga faqja zyrtare e ZRRE-së.**



**Së bashku me aplikacionin, aplikantët duhet të sjellin dokumentet e mëposhtme për verifikim:**

- Jetë përshkrimi (CV);
- Dëshmi të kualifikimeve arsimore;
- Dëshmi mbi përvojën e punës e dëshmuar me Trust;
- Raporti i vlerësimit të fundit nga mbikëqyrësi i tij/saj (për ata që janë të punësuar në sektorin publik);
- Një Letër-rekomandim;
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi që nuk ka masë disiplinore për shkelje të rënd në institucione publike, ndërsa për ata të sektorit privat një vetë-deklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore të rëndë në institucion publik;
- Dokument identifikimi valid të Republikës së Kosovës (letërnjoftimi).

**Gjatë aplikimit ONLINE, përmes emailit zyrtar: [rekrutimi@ero-ks.org](mailto:rekrutimi@ero-ks.org) , aplikacioni i plotësuar dhe dëshmitë e kërkuara mësipër, duhet të skanohen dhe të dërgohen si dokumente të vetëme në formatin .pdf (jo më e madhe se 5 MB).**

**Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.**

**Nëse numri i aplikacioneve të pranuar është më i vogël ose i barabartë me numrin e pozitave të lira, apo më pak se 3 kandidatë kur është vetëm një pozitë për të cilat zhvillohet procedura e konkurrimit, afati për aplikim vazhdohet edhe për tri (3) ditë kalendarike. Nëse edhe pas zgjatjes së afatit, nuk pranohen aplikacioneve tjera, NJBNJ e ZRRE-së vazhdon procedurën me numrin aplikacioneve të pranuar në të dyja afatet.**

**Aplikacionet duhet të dorëzohen ONLINE, në email adresën zyrtare: [rekrutimi@ero-ks.org](mailto:rekrutimi@ero-ks.org)**

**Rr. Bekim Femi (Ish. Ndërtesa Fazita) Kati 2, 10000**

**Prishtinë, Kosovë**

**Tel.+ 381 247 615 ext.104 ose 109**

**Të dhëna shtesë:**

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.



*Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin zyrtar 038 247 615 109, ose 038 247 615 104, por mund të shkruani edhe në emalin zyrtar: [rekrutimi@ero-ks.org](mailto:rekrutimi@ero-ks.org), në rast se nuk e keni pranuar njoftimin se aplikacioni juaj është pranuar!*